

VENDIM
Nr.651, datë 14.9.2011

PËR LICENCIMIN E AKADEMISË PROFESIONALE TË BIZNESIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, e 43, 44, 44/1 e 45, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e Akademisë Profesionale të Biznesit, e cila ushtron veprimtarinë në qytetin e Tiranës.
 2. Akademia Profesionale e Biznesit organizohet në dy fakultete:
 - a) Fakulteti i Ekonomisë;
 - b) Fakulteti i Drejtësisë.
 3. Format e studimeve në Akademinë Profesionale të Biznesit janë studime me kohë të plotë dhe studime me kohë të pjesshme.
 4. Fakulteti i Ekonomisë ofron:
 - a) Programet e studimit të ciklit të parë, në përfundim të të cilit merret diploma “Bachelor” në “Ekonomi” në tri profile:
 - i) Banka dhe institucione financiare;
 - ii) Administrim biznesi;
 - iii) Financë kontabilitet.
 - b) Programet e studimit të ciklit të dytë, në përfundim të të cilit merret diploma “Master profesional” në:
 - i) Kontabilitet financë;
 - ii) Menaxhim biznesi.
 5. Fakulteti i Drejtësisë ofron:
 - a) Programet e studimit të ciklit të parë, në përfundim të të cilit merret diploma “Bachelor” në:
 - i) Drejtësi;
 - ii) E drejtë biznesi.
 - b) Programet e studimit të ciklit të dytë, në përfundim të të cilit merret diploma “Master i shkencave” në:
 - i) E drejtë penale;
 - ii) E drejtë civile dhe tregtare.
 6. Akademia Profesionale e Biznesit, Tiranë fillon veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
 7. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
 8. Akademia Profesionale e Biznesit, Tiranë, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në aktet nënligjore në fuqi.
 9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Akademia Profesionale e Biznesit, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha